

Si të mbroni biznesin tuaj nga sulmet DDoS?



Çfarë është një sulm DDoS?

Sulmi DDoS është një sulm në rrjet, synimi i të cilës është që një website ose rrjet të shkëputet për një periudhë kohore, duke e ngarkuar me trafik të tepërt dhe duke e bërë shërbimin e tij të padisponueshëm.



Nëse biznesi juaj është online, mund të jetë në rrezik ndaj një sulmi DDoS

Hulumtoni më poshtë disa fakte

\$10

Sulmuesit DDoS mund të nxjerrin rrjetin tuaj offline për një kosto shumë të ulët sa 10\$

341%

Që nga fillimi i pandemisë e deri tani sulmet DDoS janë rritur me 341%

\$30,000

Një sulm DDoS mund t'i kushtojë biznesit tuaj kaq shumë para çdo orë.

10 Billion

10 bilion pajisje të disponueshme në vitin 2021, përdorshin në një sulm DDoS

Si mund të dëmtojë biznesin tuaj një sulm DDoS?



Duke ndërprerë vazhdimësinë e biznesit



Humbje financiare dhe biznesi



Dëmtim i reputacionit



Të qenit vulnerabël ndaj një sulmi më të madh

Çfarë mund të bëni për të mbrojtur veten nga një sulm DDoS



Segmentimi i rrjetit

segmentimi i rrjeteve në pjesë më të vogla, më të menaxhueshme, mund të kufizojë ndikimin e një sulmi DDoS. Kjo mund të bëhet duke krijuar VLAN.



Përdorni një "Content Delivery Network."

Ridrejton trafikun te serverët globalë duke liruar në këtë mënyrë një pjesë të trafikut në rrjetin tuaj për ta bërë atë më të menaxhueshëm.



Përdorni platformat cloud

Mbrojtja e bazuar në platformat cloud mund të shkallëzojë dhe trajtojë me lehtësi edhe një sulm të madh DDoS.



Aktivizoni FireWalls për sulme të sofistikuara të aplikacioneve

Një praktikë e mirë është përdorimi i një Web Application Firewall (WAF) kundër sulmeve të tilla. Do jeni në gjendje të krijoni lehtësisht masa zbutëse të personalizuar kundër kërkesave të paligjshme si maskimi i trafikut ose kërkesa që vijnë nga IP keqdashëse.